



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 232 Prot.

Tiranë më, 18.02.2019

Lënda: **Kthim përgjigje kërkesës për pajisje me Akt Përputhshmërie për dokumentin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vorë**

**BASHKISË VORË**

*Adresa: Rruga "Unaza", Vorë*

Në përgjigje të shkresës Suaj me Nr. 7207 Prot, datë 26.12.2018, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit me Nr. 1646 Prot, datë 26.12.2018, me lëndë: "*Kërkesë për Akt Përputhshmërie për Planin e Përgjithshëm Vendor të bashkisë Vorë*" lidhur me kërkesën për marrjen e Aktit të Përputhshmërisë së draft PPV Bashkia Vorë, Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Neni 9, pika 2, e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, përcakton se: AKPT-ja siguron që hartimi i dokumenteve të planifikimit të territorit në nivel qendror dhe vendor, është në përputhje me dispozitat e këtij ligji, përmes ofrimit të ndihmës teknike për autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, duke:

*c) bashkërenduar vlerësimin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit në shqyrtim me Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe planet e tjera kombëtare, mbi bazën e parimit të hierarkisë së dokumenteve të planifikimit, si dhe kontrollin e tyre me të dhënat elektronike bazë dhe normat teknike të planifikimit.*

Neni 62, pika 2 e VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "*Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit*", përcakton se, AKPT-ja kryen shqyrtimin e përputhshmërisë së dokumentacionit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e botimit dhe e paraqitjes për shqyrtim të dokumentacionit të plotë.

Në vijim, sqarojmë se, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e Planit të Përgjithshëm Vendor pas botimit të plotë të tij në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT).

Sa më sipër, duke qenë se bashkia Vorë ka kryer botime shtesë të dokumentacionit të Planit të Përgjithshëm Vendor në datën 18.02.2019, AKPT-së i nevojitet 30 ditë kohë për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të botuar, sipas përcaktimeve të nenit 62, pika 2 të VKM Nr. 686/2017 dhe do t'Ju informojë mbi qëndrimin e saj zyrtar brenda datës 21.03.2019.

Me respekt,

**DREJTORE E PËRGJITHSHME**

**Adelina Greca**

Konceptoi/ Punoi: *R. Laçi - E. Pashollari*  
Pranoi/ Konfirmoi: *F. Mali*  
Nr. Kopje: 2  
Datë: 18.02.2019